



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 par. 12.1 dhe nenit 17 pika shkronja o) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 Qershor 2008, nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L -071 për sistemin e adresave . Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 29 e datës 27 Dhjetor 2011 si dhe nenit 9 shkronja o) dhe nenit 20 par. 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr. 110 -623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit, në mbledhjen e mbajtur me 27. 12. 2016, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit miratoi këtë

VENDIM
PËR EMËRTIMIN E PARKUT TË QYTETIT ME EMRIN E HEROIT TË KOSOVËS
“ISMET ASLLANI”

Neni 1

Me këtë Vendim emërtohet zona e qarkullimit publik, përkatësisht parku i qytetit me emrin e heroit të Kosovës “ISMET ASLLANI” që evidentohet në njësinë kadastrale nr P-71409044-01796-2, në vendin e quajtur Varosh ZK Lipjan në sipërfaqe prej 2385 m2 ,pronë shoqërore e shkollës fillore, pranë objektit të shkollës fillore Vëllezërit Frashëri në Lipjan.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit , Drejtorati për Gjeodezi , Kadastër dhe Pronë dhe Drejtorati për Shërbime Publike.

Neni 3

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës.

15Nr. 352 -70930
Lipjan, me 28. 12. 2016

KUVENDI KOMUNES LIPJAN



Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni